



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN:
SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (17) **FAQE 4-5**

KRIMI I GJENOCIDIT NË REÇAK DHE KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E RAMBUJESË



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së shtatëmbëdhjetë, ka folur për krimin e gjenocidit në Reçak dhe Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë. Ai

ka theksuar se masakra dhe barbaria që kishin treguar forcat ushtarake dhe policore serbe, në krimin e gjenocidit në Reçak, nuk kaloi ashtu siç e kishin planifikuar autoritetet e Beogradit. Bardhyl Mahmuti thotë se qëndrimet e shefit të Misionit Verifikues të OSBE-së në atë për Kosovën,

William Walker, tërbuan autoritetet serbe. Në këtë intervistë ai ka përmendur edhe disa fakte të Deklaratës së Grupit të Kontaktit. Ish-përfaqësuesi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka komentuar edhe deklaratën në atë kohë të Adem Demaçit kundër negociatave

AKTUALE



EGJIPTI SHPALOS NJË PLAN PËR T’I DHËNË FUND LUFTËS NË GAZË **F. 2**

KONFISKOHEN TELA GJEMBORË, BOMBA TYMOSËSE DHE MUNICION NË VERI **F. 6**

PRODUKTE PA AFAT, AVUK THIRRJE QYTETARËVE TË KENË KUJDES NGA DHURATAT PËR FËMIJË **F. 7**

EKONOMI



QYTETARËT E KOSOVËS, BORXHE DERI NË ‘FYT’, RRETH 5 MILIARDË EURO KREDI **F. 8**

SPORT



KAMPIONI ALBAN VESELI PENSIONOHET NGA BASKETBOLLI **F. 10**

KOSOVA NGRE ALARMIN PËR SULME TË MUNDSHME NË VERI **F. 3**



VETËVENDOSJA, PJESË E OPOZITËS SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT **F. 3**



RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Egjipti shpalos një plan për t’i dhënë fund luftës në Gazë

KAJRO, 25 DHJETOR - Egjipti ka paraqitur një propozim fillestar ambicioz për t’i dhënë fund luftës në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja - me një armëpushim, një plan për lirim të pengjeve dhe me krijimin e një qeverie palestineze ekspertësh që do ta administronin Rripin e Gazës dhe Bregun Perëndimor të pushtuar, tha një zyrtar i lartë egjiptian dhe një diplomat evropian më 25 dhjetor, sipas AP. Ky plan vjen pasi sulmet ajrore izraelite goditën Gazën qendrore dhe jugore, duke shkatërruar ndërtesat e familjeve të strehuara brenda. Në kampin e refugjatëve Maghazi, punonjësit e shpëtimit nxorën dhjetëra trupa të tjerë nga rrënojat disa orë pasi një sulm rrafshoi një ndërtesë trekatëshe dhe shkatërroi disa të tjera aty pranë. Të paktën 106 njerëz u vranë, sipas të dhënave të spitalit të para nga agjencia e lajmeve “AssociatedPress”, duke e bërë atë një nga sulmet më vdekjeprurëse të fushatës ajrore të Izraelit. Propozimi egjiptian, i punuar së bashku me Katarin, i është paraqitur Izraelit, Hamasit, Shteteve të Bashkuara dhe qeverive evropiane, por ende nuk është vendosur mbi të. Ai bie jashtë qëllimit të deklaruar të

Izraelit për ta shtypur drejtpërdrejt Hamasin dhe duket se nuk përmbush këmbënguljen e Izraelit për ta mbajtur kontrollin ushtarak mbi Gazën për një periudhë të gjatë pas luftës. Kabineti i Luftës i Izraelit, përfshirë kryeministrin Benjamin Netanyahu, kishte planifikuar të takoheshin gjatë ditës për ta diskutuar situatën e pengjeve, mes temave të tjera, tha një zyrtar izraelit, i cili nuk konfirmoi nëse pjesë e diskutimit ishte edhe propozimi egjiptian. Përpara takimit, Netanyahu u zotua se do ta zgjerojë luftën ndaj Hamasit në ditët në vijim dhe shtoi se “kjo do të jetë një betejë e gjatë dhe nuk është afër përfundimit”. Lufta ka shkatërruar pjesë të mëdha të Gazës, ka vrarë më shumë se 20 400 palestinezë dhe ka zhvendosur pothuajse të gjithë 2.3 milionë banorët e territorit. Zyrtarët e OKB-së paralajmërojnë se një e katërta e popullsisë po vdes nga uria nën rrethimin e Izraelit, i cili lejon vetëm një rrjedhje të vogël furnizimesh të ndihmave humanitare. Numri në rritje i vdekjeve midis trupave izraelite - 17 që nga 22 dhjetori dhe 156 që nga fillimi i ofensivës tokësore - mund ta dëmtojë mbështetjen publike për luftën, e cila u ndez kur militantët e udhëhequr nga



Hamasi sulmuan Izraelin më 7 tetor, duke vrarë 1 200 njerëz dhe duke marrë 240 të tjerë peng. Izraeli vazhdon të insistojë në qëllimet e tij për t’i shkatërruar aftësitë qeverisëse dhe ushtarake të Hamasit dhe lirin e 129 pengjeve të mbetura. Mbështetja e publikut për këto qëllime ka qenë kryesisht e qëndrueshme, pavarësisht rritjes së presionit ndërkombëtar ndaj ofensivës së Izraelit dhe numrit të paprecedent të viktimave në mesin e palestinezëve. Edhe pse izraelitët mbështesin luftën, pakënaqësitë janë rritur

kundër qeverisë së Netanyahut, të cilin shumë e kritikojnë për dështim që t’i mbrojë civilët më 7 tetor dhe për politika që kanë lejuar Hamasin të forcohet gjatë viteve. Propozimi egjiptian ishte një përpjekje ambicioze jo vetëm për t’i dhënë fund luftës, por edhe për ta hartuar një plan për të ardhmen. Në të bëhet thirrje për një armëpushim fillestar deri në dy javë, gjatë së cilës militantët palestinezë do të lironin 40 deri në 50 pengje - mes tyre gra, të sëmurë dhe të moshuar - në

këmbim të lirit të 120 deri në 150 palestinezëve nga burgjet izraelite, tha zyrtari egjiptian për AP në kushte anonimiteti. Në të njëjtën kohë, negociatat do të vazhdojnë për zgjatjen e armëpushimit dhe lirin e më shumë pengjeve dhe trupave të mbajtura nga militantët palestinezë, tha ai. Një diplomat perëndimor tha se ata janë në dijeni të propozimit të Egjiptit. Por diplomati, i cili foli gjithashtu në kushte anonimiteti, dyshon se Netanyahu dhe qeveria e tij do ta pranenin këtë propozim.

Studentë bllokojnë rrugën në qendër të Beogradit, duan qasje në listën zgjedhore

BEOGRAD, 25 DHJETOR - Më 25 dhjetor një grup studentësh në Beograd të Serbisë bllokuan trafikun në kryqëzimin e rrugëve “Kneza Millosha” dhe “Birčaninova”, duke kërkuar që autoritetet në Serbi ta lejojnë inspektimin publik të listës së votuesve. Ky lokacion është një nga më të ngarkuarit në kryeqytetin e Serbisë. Rreth tij gjenden ndërtesat e Qeverisë së Serbisë, ministri të shumta dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Serbe. Paraprakisht, me të njëjtën kërkesë, studentët protestuan edhe para selisë së Ministrisë së Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale në Birčaninovë. Ata njoftuan se duan qasje në listën e votuesve për ta kontrolluar atë, pasi që organizata vendëse dhe evropiane që vëzhguan zgjedhjet në Serbi më 17 dhjetor shprehën dyshime për rregullsinë e tyre.



Një nga organizatorët e bllokadave, Ivan Bijeliq, tha se do të paraqesë kërkesë tek të gjitha pushtetet lokale për kontroll të listave zgjedhore dhe se do të kenë kohë t’u japin qasje deri të mërkurën, më 27 dhjetor, në

mesditë. Ata njoftuan se bllokada do të zgjasë deri në orën 18:00 dhe njoftuan se protestave në Beograd u janë bashkuar edhe studentët e Universitetit të Novi Sadit. Siç thanë ata, nuk do të ketë bllokada

më 26 dhjetor. Ministria e Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale tha më 25 dhjetor se lista zgjedhore është “një nga bazat e të dhënave më të përditësuara” në Serbi. “Dëshirojmë t’ju rikujtojmë

se deri në vitin 2012 çdo komunë apo qytet e ka menaxhuar vetë listën zgjedhore dhe se një mënyrë e tillë menaxhimi ka pasur mangësitë e veta. Meqenëse të gjitha të dhënat janë konsoliduar në vitin 2012 dhe është krijuar Lista e Unifikuar Zgjedhore, është siguruar kontroll i plotë, saktësi dhe afat kohor i të dhënave”, thuhet në reagimin e kësaj ministrie. Siç thuhet në njoftim, “Ministria ka punuar në vazhdimësi për përmirësimin e kësaj baze të dhënash në 11 vjetët e fundit dhe rezultatet e asaj pune janë të dukshme”. Ministri i Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale, Aleksandar Martinović, deklaroi se qëllimi i tubimit me ftesë të koalicionit “Serbia kundër dhunës” është “marrja e pushtetit në Serbi me dhunë”. Martinović shtoi se “ai do të jetë me presidentin me të gjitha forcat”.

Kosova ngre alarmin për sulme të mundshme në veri

Sipas kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, një grup prej 80 personash që janë larguar nga Kosova pas sulmit në Banjska po vazhdojnë stërvitjet në poligone ushtarake serbe. Por, Serbia i hedh poshtë këto pretendime



PRISHTINË, 25 JANAR - Autoritetet në Kosovë kanë ngritur alarmin për sulme të reja të mundshme në veri të Kosovës. Kryeministri Albin Kurti tha se Millan Radoiçiqi, ish-nënkryetar i Listës Serbe, që mori përgjegjësinë për sulmin në Banjskë, po përgatit sulme të reja ndaj Kosovës së bashku me grupin që kreu sulmin e 24 shtatorit ku mbeti i vrarë një polic i Kosovës dhe më pas tre sulmues.

Në një konferencë në fundjavë, duke u bazuar në informacione të inteligjencës së Kosovës, Kurti përmendi disa lokacione në Serbi, ku grupi, sipas tij, po kryen trajnime, përfshirë poligone ushtarake të Serbisë. Pretendimet e kryeministrit të Kosovës u hodhën menjëherë poshtë nga Ministria Serbe e Mbrojtjes. Kryeministri Kurti nuk ofroi dëshmi por, sipas tij, "Milan Radoiçiqi mban takime të rregullta me inteligjencën serbe dhe se pjesëtarët e grupit të tij paguhen 2 000 euro në muaj". "Kumtimi i urdhrat për sulmin në Banjskë ishte dhënë në ambientet e kompanisë Novi Pazar Put, në pronësi të Zvonko dhe Zharko Vesellinoviç, që kanë qenë partnerë biznesi të Radoiçiqit. Pas sulmit terrorist, Millan Radoiçiqi u lirua nga gjykata serbe në kohë rekorde. Ai tash po vazhdon përgatitjet për sulme të tjera në Kosovë, bashkë me disa pjesëtarë të organizatës terroriste Mbrojtja Civile", tha kryeministri Kurti. Duke zbuluar

të dhëna, kryeministri Kurti tha se "Radoiçiqi është duke mbajtur takime të rregullta me zyrtarë të lartë të inteligjencës serbe (BIA)". "Ambientet e firmës 'Jabllanovica' në Rashkë, si ato të Novi Pazar Put, po përdoren për strehimin dhe ruajtjen e automjeteve dhe mjeteve eksplozive për sulmet e ardhshme nga Radoiçiqi dhe grupi i tij. Realisht, në këtë ndërtesë strehohen disa anëtarë të 'Mbrojtjes Civile', që kryejnë vëzhgime në territorin e Kosovës", tha Kurti. Ai, po ashtu, përmendi edhe një poligon të ushtrisë serbe në Peshter, ku, sipas tij, kanë rinisur ushtrimet e një grupi prej 60 personash të "Mbrojtjes Civile" që, sipas Kurtit, "kanë marrë pjesë në sulmin në Banjskë". "Mbrojtja Civile" dhe "Brigada e Veriut", dy organizata të serbëve të veriut në Kosovë, cilësohen organizata terroriste. "Ky grup kishte planifikuar sulme ndaj policisë sonë pas përfundimit të zgjedhjeve në Serbi në lokacionet kufitare që lidhen me rrugët ilegale alternative", tha Kurti. Sipas tij, Kosova në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë është e përgatitur që të zmbarsë sulme të tilla.

Serbia mohon akuzat

Sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme të Kosovës, që nga viti 2021 e deri më tash "Policia e

Kosovës ka qenë cak i 114 sulmeve në veri", kryesisht të kryera nga grupi që kreu sulmin në Banjskë të Zveçanit. Menjëherë pas këtyre deklarimeve të kryeministrit Kurti, Ministria e Mbrojtjes e Serbisë mohoi këto akuza duke i quajtur "absurde". "Është gënjeshtër dhe absurdi i plotë që terrenet stërvitore të Forcave të Armatosura të Serbisë po përdoren për stërvitjet e ndonjë njësie, me përjashtim të njëjësive të Forcave të Armatosura të Serbisë dhe herë pas here edhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme", tha Ministria Serbe e Mbrojtjes, duke hedhur poshtë se "ka plane për sulme në territorin e Kosovës".

Shtimi i pranisë së NATO-s pas sulmit të 24 shtatorit në Kosovë

Sulmi i 24 shtatorit në Banjskë të veriut të Kosovës është cilësuar më i rëndi që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, duke ngritur edhe shqetësimin e faktorit ndërkombëtar për stabilitet në vend. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, në konferencën e tij të funditit tha se "ruajtja e një mjedisi paqësor dhe të sigurt në Kosovë është çelësi për stabilitetin e rajonit më të gjerë të Ballkanit Perëndimor. "Në këtë periudhë të vitit, falënderimet dhe respekti im më i

thellë shkon për forcat tona të NATO-s. Pa ju nuk do të kishte NATO, nuk do të kishte siguri dhe nuk do të kishte liri. Shërbimi i tyre na mban pa rreziqe, të sigurt dhe të lirë", tha Stoltenbergu. Aleanca veriatlantike këtë vit dërgoi qindra trupa shtesë duke e rritur numrin në 4 600 trupa. Rritja e numrit të ushtarëve u bë pas trazirave në veri pas vendosjes së kryetarëve shqiptarë në katër komunat me shumicë serbe, ku serbët lokalë plagosën dhjetëra ushtarë të KFOR-it si dhe pas sulmit në Banjskë më 24 shtator, ku grupe serbësh të armatosur sulmuan policinë e Kosovës, duke vrarë një polic.

Thirrje për heqjen e masave ndëshkuese

Sidoqoftë, udhëheqësit e Kosovës i bënë thirrje Bashkimit Evropian t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës dhe ta ndëshkojë Serbinë për, siç thonë, "veprime armiqësore ndaj Kosovës dhe largim nga marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve". Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se "masat e vendosura nga Bashkimi Evropian pas tensioneve të fundit ishin të padrejta". "Ato që janë kërkuar nga Kosova për atë që e quanin depërshkallëzim, tashmë kanë ndodhur dhe masat është dashur të hiqeshin tashmë, sepse janë masa që në mënyrë të

padrejtë ndikojnë negativisht në jetën e qytetarëve tanë për shkak të projekteve që janë bllokuar, të cilat kryesisht u dedikohen komunave", tha presidentja Osmani.

Sipas saj, ka tendencë nga disa që tani masat të keqpërdoren si mënyrë për ta kushtëzuar Kosovën për çështje të ndryshme nga ato për të cilat janë vendosur. Një qasje e tillë, sipas presidentes Osmani, është e papranueshme. Edhe kryeministri Albin Kurti, në një postim në rrjetet sociale, kërkoi heqjen e masave ndëshkuese dhe që Kosovës t'i jepet statusi i vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në programin e Partneritetit për Paqe me NATO-n. "Pikërisht kështu partnerët tanë perëndimorë do t'i kërkonin fuqishëm Serbisë ta zbatonte detyrimin e njohjes de facto të Kosovës", tha ai. Kurti shfaqti shpresën se "Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara do t'i vendosin sanksione Serbisë për sjelljet dhe veprimet armiqësore e agresore ndaj Kosovës dhe për heqjen dorë nga marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve". Marrëveshja e arritur në Ohër me ndërmjetësim të BE-së kërkon marrëdhënie të mira fqinjësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Udhëheqësit më të lartë evropianë Kosovës i kërkuar themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa Serbisë njohjen de facto të Kosovës.



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (17)

Krimi i gjenocidit në Reçak dhe Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së shtatëmbëdhjetë, ka folur për krimin e gjenocidit në Reçak dhe Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë. Ai ka theksuar se masakra dhe barbaria që kishin treguar forcat ushtarake dhe policore serbe, në krimin e gjenocidit në Reçak, nuk kaloi ashtu siç e kishin planifikuar autoritetet e Beogradit. Bardhyl Mahmuti thotë se qëndrimet e shefit të Misionit Verifikues të OSBE-së në atë për Kosovën, William Walker, tërbuan autoritetet serbe. Në këtë intervistë ai ka përmendur edhe disa fakte të Deklaratës së Grupit të Kontaktit. Ish-përfaqësuesi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka komentuar edhe deklaratën në atë kohë të Adem Demaçit kundër negociatave

PRISHTINË, 25 DHJETOR-
“Epoka e re”: Siç e përmendët më lart, në takimet e ngjeshura diplomatike që kishit në atë kohë me bartës të institucioneve të BE-së dhe të diplomacisë amerikane, ju shpalosët prova të pakontestueshme se Serbia nuk u përmbahej kërkesave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për armëpushim dhe ndërprerje të armiqësisë. Përkundër vendosjes së Misionit Verifikues të OSBE-së për ta mbikëqyrur respektimin e kushteve të vendosura me anë të

rezolutës 1199, gjendja shkoi duke u përkeqësuar. Më 15 janar 1999 ndodhi krimi i gjenocidit në fshatin Reçak, ku u masakruan 45 shqiptarë. Për çfarë arsye kjo ngjarje pati ndikim të madh në reagimin e institucioneve ndërkombëtare?
Bardhyl Mahmuti: Gjatë procesit të shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë, ndërmjetësuesve ndërkombëtarë u kishte ardhur në majë të hundës mosrespektimi i vazhdueshëm i marrëveshjeve nga ana e serbëve në Kroaci dhe Bosnjë. Vendosja e

Misionit të OSBE-së me qëllim që të shmangej katastrofa humanitare në Kosovë ishte shpresa e fundit për të krijuar parakushtet e një zgjidhjeje të çështjes së Kosovës nëpërmjet dialogut politik. Mirëpo, siç doli më vonë në shesh, pushteti në Beograd shpresonte ta nxiste ndërhyrjen e NATO-s, duke menduar se do të kishte “pak bombardime”, si në Bosnjë, dhe ta shfrytëzonte këtë rast si pretekst për ta realizuar projektin e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Mirëpo masakra dhe barbaria që kishin treguar forcat ushtarake dhe policore serbe, në krimin e gjenocidit në Reçak, nuk kaloi ashtu siç e kishin planifikuar autoritetet e Beogradit. Më 15 janar 1999, në ditën kur pushteti serb ishte në dijeni se shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së për Kosovën, William Walker, ndodhej për vizitë zyrtare në Mal të Zi, forcat ushtarake dhe policore serbe kryen akt gjenocidi ndaj shqiptarëve të fshatit Reçak. Mirëpo masakra dhe barbaria që kishin treguar forcat serbe nuk kaloi ashtu siç e kishin planifikuar autoritetet e Beogradit. Të nesërmen, rreth orës 15, William Walker dhe zëvendësi i tij, gjenerali anglez Karol John Drewienkiewicz, vizituan vendin e krimit dhe pa asnjë hamendje shefi i Misionit deklaroi: “Janë vrarë me nga një plumb në kokë ose pas qafe”!
“Epoka e re”: Më kujtohet se në konferencën për shtyp që organizoi atë mbrëmje të 16 janarit kur u kthye nga Reçaku, z. William Walker deklaroi se

“megjithëse nuk ishte jurist, sipas tij, në këtë fshat kishte ndodhur një krim kundër njerëzimit”!
Bardhyl Mahmuti: E saktë! Përveç cilësimit të krimit në Reçak si krim kundër njerëzimit, në këtë konferencë me gazetarë, ambasadori Walker tha: “Unë i akuzoj forcat policore dhe ushtarake serbe se janë përgjegjëse për këtë masakër. Para disa ditësh, Ushtria Çlirimtare e Kosovës liroi 8 ushtarë serbë. Prisnim një masë reciprociteti. E çka kemi në vend të saj? Vrasje të 40 civilëve të pafajshëm. Dëshiroj të di se kush ka dhënë urdhër. Duhet të dalin para drejtësisë. Kam kërkuar nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë t’i dërgojë ekspertët e vet brenda 24 orëve, me ose pa viza, dhe e këshilloj qeverinë serbe t’i lejojë të hyjnë në territorin jugosllav”.
 Një hapësirë e jashtëzakonshme në mediet ndërkombëtare iu dha deklaratave të shefit të Misionit Verifikues të OSBE-së për Kosovën, William Walker. Qëndrimet e tij tërbuan autoritetet serbe!

Jo vetëm që nuk i përfillën këshillat e tij, por të nesërmen e konferencës për shtyp të Walkerit, më 17 janar 1999, edhe pse ishte ditë e diel, Qeveria e Beogradit, në mbledhjen e saj të jashtëzakonshme, shpalli William Walkerin “*persona nongrata*” dhe i dha një afat prej 48-orësh për t’u larguar nga Jugosllavia. Në të njëjtën ditë, me arsyetim se mandati i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë kishte të bënte me konfliktet e armatosura e jo me operacionet policore kundër terroristëve, autoritetet e Beogradit nuk i lejuan prokurores së atëhershme të kësaj gjykate, Louise Arbour, hyrjen në Jugosllavi.

“Epoka e re”: *Megjithatë përpjekjet serbe për ta penguar ndriçimin e krimit në Reçak dështuan. Më 29 janar 1999, Grupi i Kontaktit për ish-Jugosllavinë shtroi si domosdoshmëri mbajtjen e një konference ndërkombëtare për Kosovën. Si u prit Deklarata e Grupit të Kontaktit?*

Bardhyl Mahmuti: Që të kuptohet drejt nga lexuesit e rinj rëndësia e madhe e kësaj deklarate po përmend disa fakte: - Çështjen e Kosovës Serbia e konsideronte si problem të brendshëm të saj dhe refuzonte çdo ndërmjetësim ndërkombëtar. - Në qëndrimet paraprake të Grupit të Kontaktit, të BE-së dhe të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, zgjidhja e çështjes së Kosovës shihej nëpërmjet dialogut të drejtpërdrejtë të autoriteteve serbe dhe të përfaqësuesve të partive politike të Kosovës. Deklarata e Grupit të Kontaktit imponoi ndërmjetësimin ndërkombëtar në përpjekjet për gjetjen e një zgjidhjeje politike dhe për këtë arsye kjo deklaratë paraqet kthesën vendimtare në trajtimin e çështjes së Kosovës.

“Epoka e re”: *Më 29 janar 1999 nga Londra dhatë një intervistë për agjencinë “Reuters”, e cila u transmetua në BBC, CNN dhe “Euronews”. Ju e përkrahët publikisht Deklaratën e Grupit të Kontaktit. Meqenëse në atë kohë ishit në Londër, a patët ndonjë takim paraprak me diplomatë që merrnin pjesë në këtë takim?*

Bardhyl Mahmuti: Një ditë përpara deklaratës në fjalë udhëtova në Londër me kërkesë të ambasadorit Rosin. Në bisedën që zhvilluam në të njëjtin hotel ku mbahej takimi i Grupit të Kontaktit, ai më njoftoi se Rusia dhe Italia kundërshtonin pjesëmarrjen e përfaqësuesve të UÇK-së në konferencën ndërkombëtare, me arsyetim se nuk bëhej fjalë për bisedime ndërmjet forcave ushtarake dhe se Serbia do të refuzonte të bisedonte për çështje politike me “terroristët”. Delegacioni i ShBA-së dhe ai i Mbretërisë së Bashkuar këmbëngulte në përfshirjen e përfaqësuesve politikë të UÇK-së, sepse vetëm ata ishin përfaqësues legjitimë të saj! Këtë qëndrim e

mbështetën edhe anëtarët e tjerë të Grupit të Kontaktit (Franca, Gjermania dhe Irlanda Veriore) dhe në fund Grupi i Kontaktit pranoi të mos ndërhynte se kush do ta përfaqësonte Kosovën në këtë konferencë.

“Epoka e re”: *A patët mundësi t’i njoftonit përfaqësuesit e tjerë politikë për përmbajtjen e takimit që patët me ambasadorin Rosin, sepse në të njëjtën ditë kur u transmetua intervista juaj në mediet e lartpërmendura, mediet në Kosovë i dhanë një publicitet të madh intervistës që z. Demaçi i kishte dhënë një televizioni sloven një ditë më parë?*

Bardhyl Mahmuti: Në pamundësi ta njoftoja Zyrën e UÇK-së në Prishtinë, sepse gjatë atyre ditëve Adem Demaçi ishte në Slloveni për analiza mjekësore, njoftova Xhavit Halitin. Ai ishte plotësisht dakord që UÇK-ja të merrte pjesë në Konferencën e Rambujesë. Nuk e di nëse Xhaviti ka mundur t’ua përcjellë përfaqësuesve të

tjerë. Ndërkaq mediet në Kosovë kanë shtrembëruar përmbajtjen reale të intervistës së Përfaqësuesit të Përgjithshëm Politik të UÇK-së. Fillimisht ta sqarojmë lexuesin se kjo intervistë ishte transmetuar një ditë përpara se të bëhej publike Deklarata e Grupit të Kontaktit. Çdokush që lexon brendinë e njoftimit lidhur me intervistën e Adem Demaçit do të shohë se titulli nuk përkon aspak me brendinë.

Adem Demaçi, që njihte jashtëzakonisht mirë funksionimin e pushtetit të Serbisë, tërhoqi vëmendjen në logjikën që kishin zbatuar serbët gjatë luftës në Bosnjë, ku nga njëra anë “bisedonin për të gjetur një zgjidhje politike”, ndërsa, nga ana tjetër, kryenin krimet më monstruoze. Në këtë intervistë Adem Demaçi nxori si pengesë kryesore të zhvillimit të negociatave këtë aspekt të funksionimit të Serbisë, ndërkaq gazetarët e papërgjegjshëm,

nëpërmjet titullit bombastik kinse **“Demaçi është kundër negociatave”**, bartnin përgjegjësinë te ne!!!

“Epoka e re”: *Cili ishte efekti i kësaj deklarate të z. Demaçi?*

Bardhyl Mahmuti: Edhe përpara kësaj interviste Adem Demaçi kishte shprehur publikisht të njëjtat qëndrime. Nuk e di deri në çfarë mase kanë mundur të ndikojnë deklaratat e atij që fliste nga Prishtina në emër të UÇK-së, por është fakt i pakontestueshëm se pika e parë nga dhjetë 10 pikat që nuk mund të negocioheshin në këtë konferencë ishte *“domosdoshmëria e ndërprerjes së menjëhershme të dhunës dhe respektimi i armëpushimit”!*

“Epoka e re”: *Kur folët për takimin me ambasadorin Rosin në Londër ju thatë se UÇK-në nuk mund ta përfaqësonte askush tjetër, pos përfaqësuesve të saj legjitimë. Në çka mbështetej legjitimiteti i Drejtorisë Politike, nëse*

përfaqësuesit e saj nuk kanë dalë nga një proces zgjedhor?

Bardhyl Mahmuti: Në politologji legjitimiteti nuk kufizohet në procedurat zgjedhore, por shënjon, para se gjithash, atë strukturë përfaqësimi që arrin të identifikohet me aspiratat e një projekti politik dhe që arrin të dëshmohet si bartës dhe realizues i vetëm i saj.

Drejtoria Politike e UÇK-së kishte trashëguar një kontekst të tillë ku institucionet më të rëndësishme të skenës politike ndërkombëtare (OKB dhe BE) e cilësonin si “organizatë terroriste”. Brenda gjashtë muajsh të punës intensive diplomatike të Drejtorisë Politike, kjo situatë u përmbyës dhe jo vetëm që u hoq cilësimi negativ i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por Drejtoria Politike arriti të imponohet si forcë e patejkalueshme dhe udhëheqëse në bisedimet për ardhmërinë politike të Kosovës. Nga ky këndvështrim, ajo ishte plotësisht legjitime.

(Muhamet Mavraj / Vijon)

5

• Botë



Pas qëndrimit disaditësh në Lubjanë, ku ishte për një kontroll rutinor në klinikën e gytetit

Demaçi është kundër negociatave

“Në rrethanat ekzistuese, derisa serbët vazhdimisht na sulmojnë, është e pamundur që të ulemi dhe të bëjmë negociata”, ka deklaruar mbrëmë Demaçi në një emision informativ në televizion

LUBLJANE, 28 JANAR - Përfaqësuesi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Demaçi, ka shprehur kundërshtim ndaj presionit ndërkombëtar për negociata, në mënyrë që t’i jepet fund krizës në Kosovë.

“Në rrethanat ekzistuese, derisa serbët vazhdimisht na sulmojnë, është e pamundur që të ulemi dhe të bëjmë negociata”, ka deklaruar mbrëmë Demaçi në një emision informativ në televizion.

Ai ka theksuar se pala shqiptare nuk është e gatshme që të bëjë gabimet e

njejta të bëra në Bosnjë, ku udhëheqja myslimane ka shqyrtuar shumë plane për t’i dhënë fund luftës, derisa luftimet vazhdonin.

“Serbët duan të flasin në njërin front dhe të luftojnë në tjetrin. Ne mund të përkrahim vetëm bisedimet, të cilat do të shpiejnë në Kosovën e pavarur”, ka thënë Demaçi.

“Ne nuk do të marrim kurrfarë vendimesh të shpejta dhe as që do të lidhemi me çfarëdo afati”, ka shtuar ai.

Demaçi atë deklarim e ka bërë pak para se të largohej nga spitali në

Lubllanë, ku ka qenë, siç ka deklaruar, në analiza rutinore dhjetëditore.

Ai ka refuzuar që të nxjerrë detaje rreth shëndetit.

Demaçi lëngon nga diabeti dhe kohëve të fundit ka pasur probleme shëndetësore.

Përfaqësuesi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Demaçi ndodhet në shërim në Qendrën Klinike të Lubllanës, ka bërë të ditur të mërkurën televizioni kombëtar sloven.

Megjithatë televizioni nuk ka dhënë detaje të tjera.

Mesha e Krishtlindjes përcillet me lutje për paqe

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Në mesnatë, më 25 dhjetor, në Katedralen “Nëna Terezë” në Prishtinë është mbajtur mesha solemne e Krishtlindjes, e udhëhequr nga Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji. Gjatë fjalimit të tij, ai bëri thirrje për paqe, ndërsa shtoi se kjo festë është momenti më i mirë për ta falënderuar Zotin. “Lutem për paqe në botë sepse [mungesa e paqes] në shumë vende është duke e shkatërruar fatin

e shumë njerëzve, jetën e shumë të pafajshmëve dhe ne, që e kemi përjetuar këtë të keqe, duhet të angazhohemi që ta ruajmë paqen pas nesh”, tha Dodë Gjergji. Ai i dedikoi një pjesë të fjalimit të tij “për të gjithë njerëzit që kanë nevojë, për të sëmurit, për ata të cilëve u mungon kujdesi, dashuria”. Krishtlindja është festa më e rëndësishme në kalendarin e festave të krishtera dhe festohet çdo vit në natën mes

24 dhe 25 dhjetorit. Për ta shënuar festën e Krishtlindjes, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, vizitoi një familje katolike në Prizren. “Kësaj radhe, bashkë me Prindonin, qëndruam në familjen Laçi në Prizren. Aty ku mikpritja, tradita e filigranit dhe bashkimi i familjes me pjesën nga mërgata i japin sharm atmosferës festive”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.



Vetëvendosja, pjesë e opozitës shqiptare në Maqedoninë e Veriut

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Partia në pushtet në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje, do të jetë pjesë e koalicionit të opozitës shqiptare në Maqedoninë e Veriut, që njihet me emrin Lidhja Evropiane për Ndryshim (LEN). Kjo u bë me dije më 24 dhjetor gjatë një ceremonie për hapjen e zyrave të opozitës në Shkup, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje.

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut dhe kryetari i Lidhjes Social Demokrate, Dimitar Kovačevski, u shpreh i befusuar pasi që tha se ka parë vetëm raste kur parti të huaja mbështetin parti simotra në zgjedhje të vendeve të tjera, por jo edhe të marrin pjesë vetë në to. “Unë deri tani nuk kam dëgjuar që parti nga shtete të tjera të marrin pjesë në procese zgjedhore në shtete të tjera. Megjithatë, duhet të shihet se çfarë saktë mendon blloku opozitar pasi nëse partitë nga shtetet fqinje nisin të marrin pjesë në zgjedhjet në shtetin tonë, atëherë mund të ndodhë që parti edhe nga shtetet e tjera të marrin pjesë në zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut”, tha Kovačevski, duke shtuar se kjo nuk paraqet një dinamikë të dëshiruar. “Megjithatë, duhet të shihet se si e mendojnë pjesëmarrjen në zgjedhje dhe gjithsesi që duhet të shikohet Kodi Zgjedhor sa iu përket partive që janë të regjistruara e



kështu me radhë”, shtoi ai. LV-ja nuk është e regjistruar si subjekt politik në Maqedoninë e Veriut, por bashkëpunimi mes saj dhe tri partive opozitare Lëvizjes Besa, partisë Alternativa dhe Lëvizjes Demokratike pritet të konkretizohet me lista të përbashkëta për zgjedhjet parlamentare që do të mbahen në Maqedoninë e Veriut më 8 maj të vitit 2024. Sipas Kodit

Zgjedhor të Maqedonisë së Veriut, në zgjedhje mund të marrin pjesë vetëm partitë e regjistruara në regjistrin qendror. Ndërsa lista zgjedhore mund të përmbajë emrin e ndonjë koalicioni, siç është edhe Lidhja Evropiane për Ndryshim, por në brendi të saj duhet të theksohen emrat e partive politike që përbëjnë koalicionin.

Edhe kryeministri i Kosovës,

Albin Kurti, i cili është edhe kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, ka shprehur mbështetjen për opozitën shqiptare në Maqedoninë e Veriut gjatë vizitave në Shkup dhe Tetovë më 12 gusht 2023.

Mbështetja e Lëvizjes Vetëvendosje për bllokun opozitar në Maqedoninë e Veriut u konfirmua nga Bekim Qoku, këshilltar i Kurtit. Ai tha të dielën se LV-ja do të jetë partia e

katërt e koalicionit opozitar, me qëllim për të sjellë, siç tha ai, “ndryshimin e munguar” në Maqedoninë e Veriut. “Unë jam këtu për ta iniciuar bashkëpunimin tonë si Lëvizja Vetëvendosje, një lloj shtylle e katërt e këtij koalicioni tashmë të etabluar këtu, për ta sjellë ndryshimin e munguar tash e 20 vjet që realizohet përmes këtij regjimi që është në Maqedoninë e Veriut. Vetëvendosja natyrisht që nuk mund të rrijë duarkryq”, ka deklaruar Qoku, me prejardhje nga Struga e Maqedonisë së Veriut.

Në përbërjen parlamentare të viteve 2011-2014, Bekim Qoku ishte deputet i Partisë Demokratike Shqiptare, ndërsa më pas kaloi në radhët e Aleancës për Shqiptarët. Nga Lidhja Evropiane për Ndryshim thonë se programi zgjedhor i opozitës do të bëhet në bashkëpunim me Lëvizjen Vetëvendosje, që do të jetë edhe pjesë e listave për deputetë në përbërjen e ardhshme parlamentare.

“Lëvizja Evropiane për Ndryshim do të përbëhet nga katër parti politike. Do të thotë që në këto katër parti është edhe Vetëvendosja. Edhe programin zgjedhor e punojmë bashkërisht. Zyra është e përbashkët, edhe fushata do të jetë e përbashkët dhe do të jenë pjesë e listave parlamentare”, ka deklaruar kryetari i Lidhjes Demokratike, Izet Mexhiti.

Konfiskohen tela gjemborë, bomba tymosëse dhe municion në veri

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Policia e Kosovës ka njoftuar më 25 dhjetor se ka konfiskuar një numër të “pajisjeve të rrezikshme” në lagjen shumetnike në Mitrovicën e Veriut për të cilat tha se rrezikonin të përdroreshin për sulm ndaj zyrtarëve policorë.

Sipas njoftimit, Policia e Kosovës ishte njoftuar për këto mjete nga qytetarë të

asaj zone në orët e hershme të së hënës dhe, më pas, kishin zhvilluar një operacion kontrolli. “Aty [zyrtarët policorë] kanë gjetur: tela gjemborë të improvizuar, bomba tymosëse, municion dhe një uniformë”, thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës. Katër ditë më parë Policia e Kosovës tha se ka konfiskuar një sirenë alarmi me gjashtë zmadhues zëri në Mitrovicën e Veriut.

Në veri të Kosovës - ku jetojnë rreth 50 000 serbë që nuk i njohin institucionet e Prishtinës dhe e shohin Beogradin si kryeqytet të vetin - sirenat lëshohen kur strukturat paralele serbe duan të organizojnë ndonjë ngjarje.

Me lëshimin e tyre serbët lokalë mblidhen dhe dalin në rrugë. Kështu ka ndodhur, për shembull, në rast të protestave të ndryshme apo ngritjes së barrikadave.



Qytetarët e Kosovës, borxhe deri në ‘fyt’, rreth 5 miliardë euro kredi

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Numri i qytetarëve që kanë marrë kredi nëpër bankat e komerciale të Kosovës është rritur për rreth 13 mijë deri në nëntor të vitit 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gati 200 mijë qytetarë u janë drejtuar bankave të Kosovës për kredi gjatë këtij viti. Shuma e përgjithshme e kredive në sektorin bankar deri në muajin tetor është rreth 5 miliardë euro. Krahas kësaj, rritje ka shënuar edhe norma mesatare e interesit për dy për qind, sa ishte 6.2 për qind vitin e kaluar. Se kamatat janë rritur dhe nuk janë të favorshme thonë edhe qytetarët. Ata tregojnë se për shkak të standardit të jetesës që kanë, obligohen të hyjnë në borxhe. Për “KosovaPress”, qytetari Hysni Thaçi tha se familjarë të tij kanë marrë kredi. Ndërsa qytetari Sabri Rexha e quan “fajde” normën e interesit. Sipas tij, përveç nevojës, “njerëzit e kanë shprehi, nuk mund të jetojnë pa borxhe”. Nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) thonë se numri i përgjithshëm i kredimarrësve është 118 mijë e 102 deri në nëntor, rreth 13 mijë më shumë se vitin e kaluar. Në një përgjigje me shkrim për “KosovaPress”, nga BQK theksojnë se shuma e përgjithshme e kredive në sektorin bankar deri në muajin tetor të këtij viti është 4.8 miliardë euro. Ata shtojnë se norma mesatare e interesit për kreditë e reja në muajin tetor 2023 përlllogaritet 6.4 %, e cila në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka qenë 5.99%”, thuhet në një përgjigje me shkrim. Ndërsa themeluesi i Institutit Hulumtues për Ekonomi dhe Financa, Fehmi Mehmeti, thotë se rritja e kreditimeve vazhdon të jetë e lartë, sidomos pas

Në një përgjigje me shkrim për “KosovaPress”, nga BQK theksojnë se shuma e përgjithshme e kredive në sektorin bankar deri në muajin tetor të këtij viti është 4.8 miliardë euro. Ata shtojnë se norma mesatare e interesit për kreditë e reja në muajin tetor 2023 përlllogaritet 6.4 %, e cila në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka qenë 5.99%”, thuhet në një përgjigje me shkrim. Ndërsa themeluesi i Institutit Hulumtues për Ekonomi dhe Financa, Fehmi Mehmeti, thotë se rritja e kreditimeve vazhdon të jetë e lartë, sidomos pas



kërkuara figuron si në vijim : në periudhën (janar - nëntor) 2023 numri i përgjithshëm i kredi marrësve është, 118102 kredi marrës krahasuar me të njëjtën periudhë janar-nëntor 2022 ky numër ishte 105413 kredi marrës, kemi një rritje te kredi marrësve ne mes te dy periudhave është 12689. Sipas të dhënave të regjistrit kreditor, këtu kemi të bëjmë me përfshirjen e kredi marrësve fizik dhe juridik e që kanë marrë kredi në institucione bankare, institucione mikro financiare dhe produkte te natyrës kreditore te kompanitë e sigurimeve. Shuma e përgjithshme e kredive në sektorin bankar në muajin tetor

2023 është 4.8 miliardë euro. Norma mesatare efektive e interesit për kreditë e reja në muajin tetor 2023 përlllogaritet 6.4%, e cila në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar përlllogaritet 6.2%”, thonë nga BQK-ja për “KosovaPress”. Edhe nga Shoqata e Bankave të Kosovës potencojnë se është rritur për mbi 1 miliard euro vlera e kredive të reja të raportuara deri në shtator të vitit 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ata shtojnë se kjo vlerë është për 8.91 % më e lartë se në vitin 2022. “Vlera e kredive të reja të raportuara deri në shtator 2023 është 1.5 miliard euro. Krahasuar

me periudhën njëjtë të vitit 2022 kjo vlerë është 8.91 % më e lartë. Vlera totale e kredive aktive nga sektori bankar në Kosovë është 4.7 miliard euro e raportuar në shtator të vitit 2023. Në gusht të vitit 2023, norma mesatare e interesit për kreditë e reja në Kosovë e raportuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është 6.7%, ndërkaq në krahasim me periudhën e njëjtë të raportimit të vitit të kaluar ka qenë 5.99%”, thuhet në një përgjigje me shkrim. Ndërsa themeluesi i Institutit Hulumtues për Ekonomi dhe Financa, Fehmi Mehmeti, thotë se rritja e kreditimeve vazhdon të jetë e lartë, sidomos pas

pandemisë. Këtë rritje Mehmeti e vlerëson të mirë pasi, sipas tij, ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit. Përveç rritjes së kredive, edhe depozitat kanë arritur në vlerën 5 miliardë e 875.9 milionë euro. Ndërsa bankat komerciale në Kosovë kanë arritur të sigurojnë profit të lartë gjatë periudhës janar-tetor 2023. Sipas raportit të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për dhjetë muaj të këtij viti nga kreditë bankare dhe shërbimet e tjera bankat komerciale kanë pasur fitim të pastër 141 milionë euro ose rreth 20 milionë euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Produkte pa afat, AVUK thirrje qytetarëve të kenë kujdes nga dhuratat për fëmijë



PRISHTINË, 25 DHJETOR - Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit tha se brenda vitit mbi 300 mijë kilogramë të produkteve të mishit dhe 1 milion kilogramë të produkteve të tjera joshtazore janë asgjësuar. Agjencia foli për RTV21 në prag të festave të fundvitit. Ajo shtoi se ka shtuar numrin e kontrolleve të operatorëve ekonomikë. Qytetarët kanë shprehur shqetësimet e tyre me cilësinë e ushqimeve që konsumojnë, ndërkohë që Shoqata “Konsumatori” thotë se institucionet nuk kanë krijuar partneritet konsumator-inspeksion. AVUK u ka bërë thirrje qytetarëve të kenë më shumë kujdes nga dhuratat e fëmijëve për shkak të mundësisë së skadimit të afatit të produkteve. Drejtori i shëndetit publik, Flamur Kadriu, tha se inspektorët e Agjencisë kanë

ndaluar një numër të operatorëve ekonomikë për shkak të dyshimeve për cilësinë e dobët të ushqimit që shitet. AVUK tha se ka trajtuar 460 ankesa të konsumatorëve brenda një viti por, pavarësisht prej paralajmërimeve të Agjencisë së Veterinarisë dhe Ushqimit për kontrollet shtesë, qytetarët janë skeptikë çfarë konsumojnë. Mungesën e kontrollit në treg e ka konfirmuar edhe kryetari i Shoqatës “Konsumatori”, Selatin Kaçaniku, sipas të cilit, ato kryhen në bazë të mundësive dhe të kapaciteteve që kanë institucionet. Ai tha se në Kosovë asnjëherë nuk ka pasur kontrolle të mjaftueshëm të ushqimeve. Sipas Agjencisë së Veterinarisë, në periudhën janar-nëntor janë shqiptuar 135 gjoba për kundërvajtje për ruajtje të produkteve në kushte joadekuate.

Nastradin Hoxha në kujtimet e Nasho Jorgaqit



Nga: Jovan BIZHYTI

Dimë shumë histori e anekdota për Nastradinin, por askush nga ne nuk është në gjendje të thotë saktë për jetën e këtij personazhi enigmatik dhe të mistershëm. Bile, shumë kohë më parë, nuk dihej as vendi i origjinës së tij. Dikur thuhej se Nastradini ishte shqiptar, ose thuhej se ka patur shumë Nastradinë. Por, e vërteta nuk është kështu.

Grupi terrorist i Banjskës i përfshirë në protestat e dhunshme në Beograd të Serbisë Kovačevski: Për shkak të subvencionimit të qeverisë, qytetarët paguajnë dyfish më pak t...

Barcelona ka dy opsione për mesfushën, që të dy vijnë nga Liga Premier Dizajnerët, kreativiteti i të cilëve me të vërtetë nuk njeh kufij Shkencëtarët japonezë kanë zhvilluar robotin i cili është projektuar për të shuar zjarret Nasho Jorgaqi, në kujtimet e tij nga vizita në vendin e këtij gjeniu të humorit, na sjell realitetin e origjinës dhe të jetës së këtij personazhi shumë popullor, që cilido komb, sidomos në Ballkan, ku ai njihet si personazh komik i humorit, e kanë personalizuar si banor të tyre. Nasho Jorgaqi shpjegon se ky personazh kaq i

njohur ka ardhur nga Lindja dhe ka hyrë edhe në Ballkan, pa dyshim edhe në Shqipëri. Atë nuk e sollën as taborët e ushtrisë dhe as funksionarët e administratës së pushtuesve osmanë, por sipas gojëdhënave, thuhet se e kanë sjellë njerëzit e thjeshtë; ata i mësuan rrugën Nastradinit dhe ai kudo ku shkoi, u ul këmbëkryq nëpër odat e vatrat e popullit. Me mesazhet e tij, hidhte rreze drite në shpirtrat e njerëzve, humor i tij i zgjuar e popullor i ndihmonte njerëzit të talleshin e të vinin në lojë shtypësit e shfrytëzuesit, si dhe veset e padrejtësitë që hasnin në jetë.

Nastradini lindi nga mençuria dhe urtësia e popullit turk. Ai doli nga trojet e Anadollit dhe nga thellësia e atij vendi ku sundonte nata aziatike. Nasho Jorgaqi gjatë vizitës që bëri në Turqi nga fundi i viteve 1970 mësoi se: “Në mes të Anadollit, në rrugën kryesore afër qytetit Eskishehir, ishte ngritur një monument i Nastradinit, i hipur mbi gomar, po i hipur së prapthi, me veshje karakteristike orientale, me çallmë të bardhë, shallvare të kuqe, dhe me opinga e dolloma ngjyrë blu. Çdo udhëtar që kalonte andej, kjo pamje dashur pa dashur e bënte të vinte buzën në gaz”.

Disa kilometra më tej gjendej vendlindja e Nastradinit, fshati Sivrisar. Atje ishte një shtëpi pa

mure, por si simbol ishte një derë e mbyllur me çelës, që mbahet si shtëpia ku ka lindur Nastradini. Turqit tregojnë se për vendlindjen e Nastradinit, hahen disa fshatra e vise në Anadoll, ashtu siç debatojnë disa qytete në Greqi për Homerin. Por, pavarësisht nga ky diskutim, një gjë pranohet nga të gjithë: në pllajat e pafund të Anadollit ku shtrihet një peizazh monoton e pak i zyrtë, është trualli prej nga doli Nastradini, çuditërisht aq gazmor e aq i pranishëm në shumë vende.

“Në qoftë se për vendlindjen e tij ka shumë diskutime”, tregon Nasho Jorgaqi, “për vendin ku ka vdekur, askush nuk e kundërshton, ku qyteti i vogël i Akshehirit, ka privilegjin të mbaj varrin e Nastradinit. Dhe, populli i këtij qyteti, për të nderuar kujtimin e tij, i ka ngritur një mauzole që është një ngrehinë tipike orientale për nga arkitektura dhe zbukurimet. Pranë mauzoleut, vizitorët shohin një pllakë metalike ku shkruhet turqisht: “Dunyanim or Tahsim Burasidor”, që shqipërohet: “Këtu është mesi i dynjasë”. Pra, mesi i dynjasë a i botës qenka në atë pllakë, ku sipas legjendës është fiksuar dhe gjurma e këmbës së gomarit të Nastradinit! Në kopshtin e mauzoleut kanë ngritur dhe një sallon modest me piktura e skulptura, vepra me

motive gazmore nastradiniane. Kudo shihet Nastradini me gomarin e vet, bashkudhëtarin e tij të pandarë”.

Në Akshehir e kudo në Anadoll, punon një artizanat i tërë me ndihmën e Nastradinit. Me Nastradinin dhe me gomarin e tij bëhen suvenire, punime druri artistike e punime me allçi, medaljone të ndryshme metalike dhe këto i jepen si kujtim vizitorëve e turistëve të ndryshëm që vijnë në ato anë.

Në Sivrisar dhe Akshehir, organizohen herë pas here festivale e konkurse të ndryshme humor, sesione shkencore e diskutime letrar-artistike. Studiues të vendit e të huaj bëjnë objekt të hulumtimeve jetën dhe veprat e tij të trashëgimisë, kushtuar këtij heroi komik të lindjes. Në datat 4 deri në 10 korrik të çdo viti, shkohet pranë liqenit të Akshehirit për të zënë kos, sipas barsuletës humoristike të Nastradinit. Duke filluar prej vitit 1959 e këtej, shkencëtarët, artistët dhe poetët nga të katër anët e botës nëpërmjet Nastradin Hoxhës ndajnë mes tyre pasuritë e krijimeve të tyre humoristike kulturore. Shfaqjet e valleve dhe koncertet e muzikës, ekspozitat e fotografisë, pikturave dhe karikaturave, shfaqjet teatrale dhe të filmave, mundësojnë që populli brenda këtyre gjashtë

ditëve të festivalit, të përjetojnë një përvojë të ndërthurur me artin dhe artistët. Prej vitit 1959 e këtej, një numër i madh i artistëve të famshëm duke e sjellë të gjallë mjeshttrin e humorit nga Akshehiri, Nastradin Hoxhën e bartën deri në ditët e sotme tolerancën e pafundme dhe ndjenjën e thellë të humorit të tij. Nastradini, ky përfaqësues i shquar i humorit popullor, ka jetuar në shekullin XIII, në kohën e rendit të selxhukëve. Të dhënat e tërthorta burimore e legjendat, tregojnë se ai nuk ka qenë njeri i thjeshtë; ka qenë personalitet i shkolluar për atë kohë; ka bërë emër për mendjen e shkëlqyer, për zgjuarsinë e hollë dhe mbi të gjitha për humorin e mprehtë origjinal e tepër komunikues. Nëpërmjet shakave dhe gazmoreve që shpeshherë e kishin burimin në mentalitetin dhe aspiratat e popullit të thjeshtë, ai propagandonte ide të shëndosha, optimizmin për jetën, një moral laik që ndihmonte njerëzit për të përballuar realitetin e rëndë të kohës.

Mirëpo, kush ishte Nastradin Hoxha?

Ishte një dijetar popullor, i cili lindi në Eskishehir në vitin 1208 dhe jetoi në Akshehir gjithë

fëmijërinë e tij. Ka kryer shkollimin në medrese, kreu edhe detyrën e imamit dhe kadiut (gjykatësit), madje thuhet se ka qenë edhe mësimdhënës në medrese. Për shkak të këtyre detyrave që kreu, me kalimin e kohës mori edhe titullin “Hoxhë”. Informatat në lidhje me jetën e Nastradin Hoxhës me kohë janë përzier me gojëdhënat popullore dhe për të thuhet se kishte veçori të jashtëzakonshme. Gomari në barsoletat e tij, në të vërtetë është simboli i qëndresës ndaj dhimbjes, vështirësive dhe urisë. Nastradin Hoxha, duke e përdorur simbolin e gomarit, njerëzve u përcillte mësim nga toleranca.

Një ditë, Nastradin Hoxha dëshironte t’u jepte një mësim të mirë fshatarëve, të cilët torturojnë kafshët e tyre me barra të rënda, ndaj ai me një thes të rëndë në supe hipën mbi gomarin e tij. Fshatarët habiten kur e shohin Hoxhë Nastradinin me thesin mbi supe hipur mbi gomarin e tij dhe e pyesin: “Si është kjo punë kështu, ti hipur mbi gomar dhe mbanë thesin mbi kurriz”? Nastradini me mendjemprehtësinë e tij, përgjigjen e ka të gatshme: “Kafsha e shkretë është duke më shërbyer ditë e natë. Pas të gjitha këtyre punëve të rënda, nuk desha ta ngarkoj edhe me këtë thes të rëndë, për këtë arsye unë e

bartë thesin mbi shpinën time”!

Njerëzit qeshën!

Përgjigjet me humor të Nastradin Hoxhës për ngjarjet ditore të zakonshme, kanë arritur deri në ditët tona. Edhe pse Nastradini nuk ka lënë pas ndonjë vepër të shkruar, humori i tij është transmetuar gojarisht deri në ditët tona prej shekullit XIII. Dihet se tregimi i parë i shkruar në lidhje me Nastradin Hoxhën, është shkruar në veprën e titulluar “Saltukname” të Ebul Hajr Rumiut në vitin 1480. Saltukname është një vepër e shkruar gjatë një periudhe 7-vjeçare, në të cilën janë mbledhur traditat gojore të turqve. Duke filluar prej shekullit të 16-të, barsoletat e Nastradin Hoxhës janë përmbledhur në libra të ndryshëm. Njëra prej këtyre librave më të vjetra është edhe “Hikajeti Kitabı Nastradin”, që është shkruar në vitin 1571. Botimi i parë i barsoletave të Nastradin Hoxhës është libri i titulluar, “Letaif”, që u botua në vitin 1837. Ndërsa libri i parë i ilustruar me figurën e Nastradin Hoxhës, u botua në vitin 1869. Në bibliotekat e ndryshme të botës, ndodhen gjithsej 68 libra në lidhje me Nastradin Hoxhën, ku 12 prej tyre gjinden në Turqi. Ndërkaq në ditët e sotme barsoletat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës.

Barsoletat e Nastradin Hoxhës

kaluan kufijtë e kohës, duke arritur edhe deri në Ballkan, në Azinë e Mesme, në Afrikën e Veriut dhe në Evropë – kryesisht edhe në Itali. Shumë barsoleta që tregohen mes popullit në Sicili, janë të frymëzuara nga Nastradin Hoxha. Shumica e popujve në Lindjen e Afër, Lindjen e Mesme dhe Azinë e Mesme, Nastradin Hoxhën e kanë njohur dhe e kanë përvetësuar me emra të ndryshëm. Arsyeja e popullaritetit kaq të madh të Nastradinit mes popujve të ndryshëm të botës është se jeta dhe humori i tij popullor janë shtrirë në shumë vende ku ai i ka shkelur me gomarin e tij, por dhe në shumë të tjera humori i tij është transmetuar gojarisht, duke u bërë pjesë e trashëgimisë popullore.

Nastradin Hoxha në barsoletat e tij kritikon shoqërinë, individët, madje edhe veten dhe duke ofruar zgjidhje për probleme të ndryshme; ai gjithmonë e jep mesazhin e tolerancës, optimizmit, vëllazërisë dhe paqes. Me personalitetin e tij të mprehtë, Nastradin Hoxha është dijetar i përjetshëm i cili i tregon njerëzve rrugën e vërtetë.

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, UNESCO, vitin 1996 e shpalli si Viti i Nastradin Hoxhës dhe me këtë rast janë shtuar edhe studimet në lidhje me këtë personalitet të humorit. Ndërkaq,

viti 2008 është pranuar si 800-vjetori i lindjes së Nastradin Hoxhës dhe në këtë vit u organizuan aktivitete të ndryshme. Ndërkohë, nuk duhet harruar edhe Konkursi Ndërkombëtar i Karikaturës kushtuar Nastradin Hoxhës, që organizohet çdo vit.

Një ditë, një grup njerëzish e ndalin Nastradin Hoxhën që ishte duke kaluar aty pranë dhe e pyesin se: “Ku ndodhet Qendra e Botës”? Hoxhë Nastradini largohet disa hapa prej tyre dhe shkopin e tij e ngulit në tokë dhe iu thotë:

– Ja këtu është Qendra e Botës.

– Si është e mundur të besohet!? – pyesnin njerëzit të habitur. Ndërsa Nastradini iu përgjigj:


– Nëse nuk më besoni, mund t’a matni ...


Nëse dëshironi që këmba e juaj të shkelë në “Qendër të Botës”, atëherë mund të vizitoni tyrben e Nasradin Hoxhës që ndodhet në Akshehir, ku është dhe pllaka me mbishkrimin “Qendra e Botës”. Të japim edhe një informatë tjetër për lexuesit tanë që nuk besojnë. Shoqata e Nastradin Hoxhës, në vitin 2007 ka marr – nga Instituti i Patentave të Turqisë – certifikatën ku shkruhet: “Akshehiri Qendra e Botës”.

Nga koha që Nastradini vdiq në Akshehir në vitin 1284, kanë kaluar disa shekuj, megjithatë koha tepër e gjatë nuk e ka vjetruar gazin dhe humorin e tij aq

popullorë. Nastradini dhe historitë humoristike të tij janë ende të gjalla në jetën e popullit turk. Edhe sot në kohë të reja, në Akshehir dhe në gjithë trevën e Anadollit bisedohet e diskutohet shumë për historitë humoristike të Nastradinit, duke e bërë atë një figurë shumë të njohur e aktuale. Në Akshehir ka dhe një komunitet të gjerë shqiptarë, shumica e të cilëve janë me prejardhje nga Kosova. Disa prej tyre e kanë ditur se Nastradini ishte nga trojet tona, por kur erdhën në Anadoll e mësuan se ai paska qenë turk dhe jo sulltan apo pasha, por i thjeshtë, dora jonë, dhe se ajo thjeshtësi e bënte të ulej fshatçe në odat e burrave dhe bënte gaz me ta.

Kjo është historia e vërtetë e këtij personazhi legjendë, që mbas shumë shekujsh të ekzistencës së tij është ende i pranishëm edhe në bisedat tona të viseve shqiptare me shprehjet: “Gomari i Nastradinit”, “Gozhda e Nastradinit”, “Muri i Nastradinit” dhe shumë legjenda e përralla që lidhen me bëmat humoristike të këtij kalorësi që ka shkelur e ka lënë gjurmë edhe në trojet tona dhe jo siç ka qenë tradita si kalorës me kalë, por me gomarin e tij që njerëzit e përfytyrojnë të hipur mbrapsht, duke lënë pas historitë e tij të humorit popullorë që nuk janë shuar dhe sot e kësaj dite!





Kampioni Alban Veseli pensionohet nga basketbolli

Alban Veseli i ka thënë lamtumirë lojës së basketbollit pas plotë 20 vitesh. Karriera e tij ka qenë e jashtëzakonshme duke fituar plotë dhjetë tituj të kampionit në nivel klubesh, kurse kontribut të madh ka dhënë edhe në fanellën e Përfaqësueses së Kosovës

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Basketbolli kampion Alban Veseli të hënën e ka zyrtarizuar pensionimin nga loja aktive e basketbollit. Ai ndihet krenarë me karrierën e pasur 20-vjeçare dhe titujt e fituar në nivel klubesh, por edhe me kontributin e madh që e ka dhënë në radhët e Përfaqësueses së Kosovës. “Momente të mrekullueshme me shumë mund e sakrificë, djersë, lot gëzimi e hidhërimi, përplot 20 vite aktivitet të kuroreduar me 10 tituj kampioni e përmbyllin zyrtarisht karrierën time sot. I lumtur dhe tejet i përmbushur që isha bashkautor në arritjen e këtyre titujve në Basketbollin Kosovar dhe Përfaqësuesen e Kosovës. Andaj, është një vendim jo aq i lehtë për t’u jetësuar sot pas dy dekadash karrierë, por mendoj se ka ardhur koha e duhur për t’u larguar nga loja aktive në parket”, ka thënë Veseli, i cili falënderoi secilin prej atyre që kontribuan gjatë zhvillimit të tij si basketbollit, por një falënderim të veçantë pati për trajnerët Fikret Shatri dhe Arben Krasniqi. “Faleminderit të gjithëve që morën pjesë në rrugëtimin tim në basketboll, përgjithmonë falënderues tifozëve të dashur, ju falënderoj për zemërsisht për përkrahjen. Faleminderit të gjithë trajnerëve e



klubeve ku unë kam dhënë kontributin tim të pa kursyer. Falënderim i veçantë i dedikohet të gjithë atyre që janë përfshirë në karrierën time ndër vite, kemi krijuar kujtime të paharrueshme së bashku dhe kam krijuar miqësi të përjetshme me secilin prej jush, nder me meritoret për këto suksese janë trajnerët Fikret Shatri dhe Arben Krasniqi”, ka deklaruar Veseli. “Për

fund por të parët nga rëndësia janë familja ime, janë njerëzit më të afërt që ishin arsye kryesore e çdo suksesi, të cilëve ju jam falënderues e mirënjohës përjetësisht, Faleminderit Prindërve të mi, në mënyrë të veçantë babait tim inkurajuesit më të madh që kam takuar dhe nga i cili gëzoj çdo arritje të jetës time”, ka përfunduar ai. Alban Veseli ka luajtur për Sigal Prishtinën, Pejën, Rahovecin dhe Yllin.

Dani Alves rrezikon 9 vite burgim

BARCELONË, 25 DHJETOR - Ish-futbollisti i Barcelonës, Dani Alves, është prej thajse një viti pas hekurave të një burgu në Barcelonë. Braziliani akuzohet se në dhjetorin e vitit 2022, përdhunoi një vajzë të re në një prej klubeve të Barcelonës. Fillimisht, ish-mbrojtësi e mohoi akuzën ndërsa më pas këmbënguli se marrëdhënia seksuale kishte ndodhur me marrëveshjen e të dy palëve. Gjithsesi, hetimet nuk flasin në favor të brazilianit dhe së fundmi është përcaktuar edhe data kur do të mbahet gjyqi në të cilin do të mësohet masa. Gjyqi për ish-lojtarin do të zhvillohet më datë 5, 6 dhe 7 shkurt të vitit 2024 dhe nëse shpallet fajtor, atëherë Dani Alves rrezikon deri në nëntë vite burg sipas kërkesës së Prokurorisë që ndër të tjera kërkon edhe një dëmshpërblim prej 150.000 eurosh për viktimën.



SHKURT

KB Peja përforcohet me Jetmir Zeriqin

Klubi i basketbollit Peja e ka bërë një tjetër “goditje” në ditët e fundit të vitit 2023. Verdhëzinjtë kanë njoftuar sot përmes faqes së tyre zyrtare se e kanë transferuar basketbollistin Jetmir Zeqiri, i cili më parë ishte pjesë e Sigal Prishtinës. Gjithashtu, ai ka luajtur edhe në Maqedoninë e Veriut. Pejanët i kanë uruar mirëseardhje përforcimit të ri, i cili do të luajë në “Karagaç” deri në fund të sezonit. Pas 14 xhirosh të zhvilluara, Peja e mbylli pjesën e parë të sezonit në Superligën e basketbollit në pozitën e dytë me 24 pikë, dy më pak se liderja Trepça. Pejanët do të mundohen ta përsërisin suksesin e vitit të kaluar kur e fituan titullin e kampionit të Kosovës.

Zhegrova kryeson në listën e dribluesve në Ligue 1

Edon Zhegrova po përjeton një nga edicionet më të mira në karrierë me fanellën e skuadrës franceze, Lille. Reprezentuesi i Përfaqësueses së Kosovës ka shkëlqyer këtë edicion në Ligue 1 – duke dhuruar spektakël në disa ndeshje. Zhegrova është i pari në listën e dribluesve më të mirë në elitën e futbollit francez, duke lënë prapa disa yje të kampionatit elitë. Anësori këmbëshpejtë ka regjistruar 46 driblime këtë sezon, po aq sa Romain Del Castillo. Ousmane Dembele ka 41 driblime, ndërkaq në pozitën e pestë është ylli Kylian Mbappe me 39 të tilla.

Tare pranon se ndjen keqardhje që nuk transferoi Cavanin dhe Kim te Lazio

Ish-drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare, foli së fundmi për mediet italiane, duke zbuluar një rast të veçantë transferimi nga koha kur ishte te klubi italian. Ai gjithashtu deklaroi se Kim Min-jae është një tjetër keqardhje për të. “Unë e kisha marrë Cavanin te Lazio. Në fund Zamparini nuk donte të ma jepte. Ishte një huazim me detyrim blerjeje”, ka thënë ish-futbollisti shqiptar. “Kim është një tjetër keqardhje. Kur ishte në Shangai, ne kishim bërë një ofertë, para se të shkonte te Fenerbahçe”, ka deklaruar Tare.

Çmimin do ta ndajë me të gjithë trajnerët e Kosovës

Ilir Daja është zgjedhur trajneri më i mirë i vitit 2023. Çmimi është ndarë në gala mbrëmjen e Federatës së Futbollit të Kosovës “Laureatët 2023”. “Ndihej i nderuar, do ta ndajë këtë titull me lojtarët e mi, presidentin Arsim Kabashi dhe bashkëpunëtorët e mi. Do ta ndajë me të gjithë trajnerët e Kosovës. Jam njëri mes jush, të gjithë japim kontribut për ritjen e futbollit të Kosovës”, ka thënë Daja.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë/ Ministarstvo Zdravstva/ Ministry of Health

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/ Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva/ Kosovo Medicines Agency

KONKURS

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në bazë të Nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale shpall konkurs për emërimin e 7 anëtarëve të Komisionit (KVPPM) si :

- 1. 3 farmacistë
- 2. 1 doktor i mjekësisë
- 3. 1 doktor i stomatologjisë
- 4. 1 farmakolog klinik
- 5. 1 anëtar kimist, biolog, biokimist etj i fushës përkatëse

Paga mujore: në bazë të takimeve

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Komisioni është përgjegjës për dhënien e këshillave teknike dhe shkencore për AKPPM lidhur me lëshimin dhe mirëmbajtjen e autorizimit për marketing të produkteve medicinale si dhe performansën dhe sigurinë e pajisjeve medicinale. Këshillat e komisionit janë rekomanduese për AKPPM.

Kualifikimi i kërkuar:

- Pozita 1 - Diploma e Universitetit - Fakulteti i Mjekësisë, Drejtimi i Farmacisë (minimum 4 vjeçar pas shkollës së mesme), së paku specializimi ose magjistratura, preferohet doktoratura.
- Pozita 2 - Diploma e Universitetit - Fakulteti i Mjekësisë, së paku specializimi ose magjistratura, preferohet doktoratura.
- Pozita 3 - Diploma e Universitetit - Fakulteti i Mjekësisë, Drejtimi i Stomatologjisë së paku specializimi ose magjistratura, preferohet doktoratura.
- Pozita 4 - Diploma e Universitetit - Fakulteti i Mjekësisë, së paku specializimi nga farmakologjia klinike, preferohet magjistratura ose doktoratura.
- Pozita 5 – fakulteti i kimisë, biologjisë, mjekësisë – biokimi etj sipas fushës së konkurimit, magjistratura nga lemia perkatese, se[paku specializimi nga biokimia klinike-per biokimistet, preferohet doktoratura

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Duhet të kenë shkathhtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri bazike në programet e kompjuterit, së paku 5 vjet përvojë profesionale, e preferueshme në nivele të larta dhe në fusha që ndërlidhen me punën e Agjencisë, njohja e gjuhës angleze e obliguar.

Kohëzgjatja e emërimit:

- Mandati është 3 vjeçar.

Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

Paraqitja e kërkesave:

- Aplikacioni dhe CV dorëzohen në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Zyra e Personelit, zyra nr. 1, kati 1. të cilës i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t’ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës, dëshminë për përvojën, dëshminë se nuk është në hetime apo i dënuar për vepër penale dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në numrin e telefonit: 038/20024243 prej orës 08:00-16:00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë/ Ministarstvo Zdravstva/ Ministry of Health

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/ Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva/ Kosovo Medicines Agency

KONKURS

Agjencia Kosove za opremu i lekove u skladu sa clanom 7 zakona broj 04/190L za medicinske proizvode i opremu najavljuje imenovanje sedam clanova komisije KVPPM kao:

- 1. 3 farmaceuta
- 2. 1 doktor medicine
- 3. 1 Doktor stomatologije
- 4. 1 klinicki farmakolog
- 5. 1 hemicar,biolog,biohemicar relevant oblast itd.

Mesecna plata:na osnovu sastanaka

Duznost i odgovornost:

-Komisija je odgovorna za pruzanje tehnicke i naucne saveti AKPPM u vezi za izdavanje i odrzavanje marketing dozvole,kao u obavljanje i bezbednost sresdstava.Saveti preporucuju Odbor za AKPPM

Odgovorna kvalifikacija:

-Pozicija 1-diploma Univerziteta-Medicinski fakultet, katedra za farmaciju, (minimum 4 godine posle srednje skole) ili barem specilizacija master, doktorat prednost.
-Pozicija 2- diploma Univerziteta-Medicinski fakultet,katedra za farmaciju specilizacija master,doktorat prednost
-Pozicija 3- diploma Univerziteta - Medicinski fakultet,katedra za stomatologiju najmanje specilizacija ili master, doktorat prednost.
-Pozicija 4- diploma Univerziteta - Medicinski fakultet, klinicki famakologiji specilizacija, doktorat prednost.

-Pozicija5-Hemijski fakultet,biologije, magistratura od oblasti konkurencije, biohemija –medicine najmanje specilizacija iz biohemije prednost je doktorat.

Sposobnost, Iskustvo, i ostali atributi potrebni:

-Mora da ima sposobnost i postavljanje i ostvarivanje stratski ciljeva institucije,odlicna komunikativost i pregovaracke bestine,dokazano sposobnost da analizira situaciju i obezbedi opcije,osnovno znanje kompjuterskih programa,najmanje 5 godina radskog iskustva,pervenstvo na visokim nivoima i u oblasti koje se odnose na rad Agencije .Znanje Engleskog jezika je potrebno.

Tranje imenjovanje:Rok je 3 godine

Datum zatvaranje konkursa: Konkurs je otvoren 15 kalendarsi dana od dana objavljivanje

Podnosenje prijava:

CV se dostavlja se u Kosovsku Agenciju za lekove i opremu, kod osoblje kancelarije, br 1 sprat 1 i u pratnji kopije dokumenta na kvalifikaciju, diploma universiteta, inostransva prilozi dokaz nostrifikacije diplome,uverenja za iskustvo,postoji dokaz i istrazi ili usuden sa krivicne delo i dokumentacije druge mere potrebne za radno mesto.

Za detaljnije informacije, možete kontaktirati Kancelariju ljudskih resursa u broj telefona: 038/20024243 od 08:00-16:00.

